

Çështje të klasifikimit të ndajfoljeve

Mr. Agim Spahiu

31 gusht 2001

Përmbledhje

Në këtë shkrim jemi marrë fund e krye me klasifikimin e ndajfoljeve. I jemi rrekur kësaj çështjeje këtu mu nga fakti se në **Gramatikën e gjuhës shqipe 1, Morfologjia** të ASHSH-së, kemi vërejtur disa luhatje e paqëndrueshmëri, që vijnë si rezultat kriteresh. Kjo çështje nuk është e përkryer as në gjuhë të tjera, por është pak a shumë më e definuar me kritere më të qëndrueshme. Prandaj, e kemi parë të arsyeshme që t' i paraqesim disa nga klasifikimet më të mira e më të qëndrueshme në gramatikat e disa gjuhëve lidhur me këtë çështje, në mënyrë që në ndonjë trajtim të mëvonshëm të kësaj kategorie leksiko- gramatikore në gjuhën tonë të zbatohen dhe të përfillen ato kritere që do të jenë më të qëndrueshme. Në disa nga gramatikat e prezantuara këtu kemi vënë re se autorët- studiuesit e ndryshëm më tepër ose kryesisht kanë favorizuar kriterin sintaksor, duke mos i lënë anash edhe kriteret e tjera, si p. sh. atë semantik etj.

Në gramatikat e gjuhës shqipe të viteve të fundit, por edhe në ato të disa gjuhëve të tjera, edhe sot e kësaj dite nuk kemi ndonjë klasifikim të kënaqshëm për këtë kategori leksiko-gramatikore. Kjo mund të shpjegohet me vetë faktin se në këto tekste normative zbatohen kritere të ndryshme, të cilat, për rrjedhojë, çojnë në përfundime të ndryshme.

Kështu, fjala vjen, në tekstin universitar **Gramatika e gjuhës shqipe I** e ASHRSH-së (botuar në Tiranë më 1995), sipas funksionit që kryejnë në fjali, ato ndahen në: **1) ndajfolje përcaktore; dhe 2) ndajfolje rrethanore**. Në grupin e parë përfshihen: **a) ndajfoljet e mënyrës dhe b) të sasisë, ndërsa në të dytin: a) të kohës, b) të vendit dhe c) të shkakut**¹. Në këtë klasifikim, sikundër shihet, merret për bazë kryesisht çështja e pozicionit të foljes me trajtën ndajfoljore. Sipas këtij teksti, ndajfoljet përcaktore kanë një lidhje më të ngushtë me fjalët që përcaktojnë dhe rendi më i zakonshëm është folje + ndajfolje, ndërsa ato rrethanore kanë zakonisht rend të anasjelltë ndajfolje + folje². Kjo do të thotë se te parat kanë një raport koheziv më të madh sesa të dytat ndaj gjymtyrës që varen.

Por ky kriter klasifikimi ka edhe disa mangësi të veta: Thuhet se klasifikimi i tyre është bërë duke e marrë për bazë funksionin që e kryejnë ndajfoljet në fjali. Dhe analogjia se, sikur mbiemrat që i përcaktojnë emrat, ashtu edhe ndajfoljet e mënyrës e të sasisë, në

¹Shih tekstin e lartshënuar, f.359- 360.

²Vep. e cit., f. 360.

atë nivel ose në një mënyrë pak a shumë të ngjashme, i përcaktojnë vetë foljet, nuk mund të jetë shumë e qëndrueshme. Kjo s' mund të jetë krejtësisht identike, sepse, po të vështrohen si gjymtyrë fjalie, në raport me foljet që i përcaktojnë, nga aspekti sintaksor, edhe grupi i parë i ndajfoljeve, edhe i dyti në raport me foljet, kanë vlerë rrethore: dalin me vlerën e rrethorit të mënyrës dhe të sasisë; sikundër ato të kohës, të vendit e të shkakut që mund të dalin me vlerë rrethore të kohës, të vendit e të shkakut. Prandaj, nuk na duket shumë i qëndrueshëm ky klasifikim që për njërin palë të ndajfoljeve të zbatohet kriteri sintaksor (grupi I), ndërsa për palën tjetër (grupi II), kriteri semantik.

Po të shikohet kjo çështje në gjuhë të tjera, do të shohim se edhe në gramatika e studime të këtyre gjuhëve ka mjaft inkonsekuenca e pasaktësi, por edhe përpjekje të suksesshme drejt një klasifikimi më të drejtë dhe më të saktë.

Kështu, b.fj. në disa gramatika të gjuhës gjermane, e sidomos të autorëve **Helbig/Buscha** mund të vihet re një konsolidim më i drejtë dhe më i qartë i kriterëve në klasifikimin e kësaj pjese të ligjëratës. Në këto tekste të gjitha ndajfoljet e kësaj gjuhe vështrohen nga dy aspekte: *nga aspekti sintaksor* (Syntaktische Subklassen) dhe nga *aspekti semantik* (Semantische Subklassen). Nga aspekti i parë merren parasysh grupe të caktuara ndajfoljesh të kësaj gjuhe që kanë vlerë adverbiale, predikative dhe atributive, në kontekst dhe përdorim të caktuar (P.sh.: Der Student arbeitet dort; Der Student ist dort; dhe: Der Student dort arbeitet bei uns.). Ndërsa nga aspekti semantik të gjitha ndajfoljet grupohen në ndajfolje: **vendore** (Lokaladverbien), **kohore** (Temporaladverbien), **mënyrore** (Modaladverbien) dhe **shkakore** (Kausaladverbien). Por, është karakteristike se këta autorë, por edhe të shumica e autorëve të kësaj gjuhe, në kuadër të ndajfoljeve të mënyrës radhisin edhe **ndajfoljet e cilësisë** (Qualität: anders, blindlings, gern), **të sasisë e të intensitetit** (Quantität und Intensität: einigermaßen, teilweise), **të instrumentit e të mjetit**, siç janë **ndajfoljet përemërore** (Instrument und Mittel: damit, hiermit, dadurch, womit), **këpujore** (Kopulative Erweiterung: auch, weiterhin), kundërshtore (Adversative) etj., kurse në kuadër të atyre **të shkakut** kanë përfshirë: ato **të kushtit** (kondicionales Verhältnis: dann, sonst, anderenfalls, nötigenfalls), **të lejimit** (konzessives Verhältnis: dennoch, gleichwohl), **të rrjedhimit** (konsekutives Verhältnis) dhe **të qëllimit** (finales Verhältnis: dazu, hierfür, wozu)³, klasifikim ky që zbatohet edhe në kuadër të fjalisë së përbërë rrethore. Ndërkaq, në *Die Grammatik*, DUDEN bëhet fjalë edhe për grupin e ashtuquajtur **të ndajfoljeve të komentit** (Kommentaradverbien) që sajohehen nga përgjigjet që vijnë nga pyetjet e ndonjë bashkëbiseduesi. Këtu është fjala për fjalëzat: *po (ja)*, *jo (nein)*, *sigurisht (sicherlich)*, *ndoshta (vielleicht)*⁴. Këto fjalëza në kapitujt sintaksorë të gramatikave të gjuhës gjermane janë trajtuar, me të drejtë, si **ekuivalenca fjalish** (Das Satzäquivalent)⁵.

Edhe në gramikat e gjuhës frënge mund ta gjejmë një klasifikim pak a shumë të ngjashëm me atë të gjuhës gjermane. Sa për ilustrim po i referohemi 2- 3 gramatikave

³Shih G. Helbig, *Deutsche Grammatik, Grundfragen und Abriss*, München, 1996, f. 74- 75; Helbig/Buscha, *Deutsche Grammatik, Ein Handbuch für den Ausländerunterricht*, 1999, f. 342- 347; Helbig/Buscha, *Leitfaden der deutschen Grammatik*, 1998, f. 136- 144; Helbig/Buscha, *Übungsgrammatik Deutsch*, München 2000, f. 145- 153; *Die Grammatik 4*, Duden, 1998, f. 369- 371 etj.

⁴Shih DUDEN, *Die Grammatik 4*, Mannheim, Leipzig, Wien, Zürich, 1998, f. 371- 372.

⁵Die Grammatik, DUDEN 4, f. 620; Helbig/Buscha *Deutsche Grammatik*, f. 529- 534 etj.

të kësaj gjuhe:

Fillimisht në gramatikën aktuale të tërë shekullit të kaluar të gjuhës frënge të autorit A.Grevisse *Precise de grammaire française* (bot. i 30- të, Bruksel, 2000), ndajfoljet klasifikohen në ndajfolje: **1) të mënyrës (la maniere); 2) të sasisë e të intensitetit (la quantite et l'intensite); 3), të kohës (le temps); 4) të vendit (le lieu); 5) të të pohimit (l'affirmation); 6) të mohimit; (la negation) dhe 7) të dyshimit (le doute)**⁶. Në grupin e ndajfoljeve të pohimit a pohore radhit fjalët si: *oui, aussi, certainement, bien, precisement, en verite, si, vraiment, sans doute* etj., në atë të mohimit ato si: *non, ne (si formë atonike), acunement, nullement, jamais, rien, personne* etj., në atë të dyshimit: *peute-entre, sans doute, probablement, vraisemblément*⁷, kurse në atë të pyetjes si: *Quand? Comment? Pourquoi? Que (ne)? Ou? Par oui? Combien?*, me të cilat pyetet për kohë, mënyrë, shkak, vend, sasi⁸. Ndërkaq, autorët R.Bergentoft, M.Nord § S. Nord *Grammaire française communucative*, (botuar në Heidelberg më 1998), të gjitha ndajfoljet i ndajnë në dy grupe: **a. ndajfoljet rrethanore** (Les adverbess de circonstance) dhe **b. të opinionit** (Les adverbess d'opinion). Në grupin e parë përfshihen ndajfoljet **1. të mënyrës, 2. të sasisë, 3. të vendit dhe të kohës**, ndërsa në grupin e dytë ndajfoljet **1. të pohimit, 2. të mohimit, 3. të dyshimit dhe 4. pyetëse**⁹. Mirëpo autorët Grevisse dhe Goosse në gramatikat e tyre të viteve të fundit e avancojnë mjaft çështjen klasifikimit të ndajfoljeve, mu nga fakti se ato vështrohen nga një këndvështrim më i gjerë, sidomos nga aspekti sintaksor, jo si elemente gjuhësore të ndara nga konteksti, nga thënia apo nga njësitë e tjera në komunikim, duke mos e lënë anash as aspektin semantik. Kështu p. sh., ata në Gramatikën e tyre të re *Nouvelle grammaire française* (bot. 3, De Boeck § Duculot, 1995) nuk e zënë ngoje asnjëherë të thonë se *fjalëzat pohuese po* dhe *mohuese jo* të jenë ndajfolje, për dallim nga klasifikimet e mëparshme të tyre në disa versione gramatikash. Për këto fjalëza flitet pak më gjerësisht në kapitullin **mbi fjalë-frazat** (Le mot-phrase)¹⁰. Kjo do të thotë se këta autorë kanë bërë një *shkëputje*, nëse mund ta quajmë, në çështjen e klasifikimit tradicional të ndajfoljeve. Përfshirja e tyre në këtë grup do të thotë se ato kanë elemente *edhe të fjalëve, edhe të frazave*, sepse me të drejtë, nga aspekti morfologjik janë vetëm fjalë të thjeshta, por nga aspekti sintaksor, në çështjen e komunikimit, të ligjërimit, ato përbëjnë një përgjigje që ngërthen në vete një a më shumë bërthama kallëzuesore, zakonisht nga ajo që del nga pyetja e bashkëbiseduesit. P. sh. *A erdhi Agroni? -Po.=Ka ardhur Agroni*. Pra, kjo **-po** ngërthen në vete fjalinë: *Ka ardhur Agroni*. Në Gramatikën tonë universitare, me të drejtë, janë konsideruar fjali të pagjymtyrëzuara¹¹. Këto *fjalëza* janë inkuorporuar në grupin e **fjalë- fjalive objektive** (Le mot-phrase objectif), ku, në mes tjerash, përfshihen edhe fjalët: *Allo! (Bonjour), Stop! Bravo! Merci, Hosanna! Pssst! Hourra!* etj., grupe këto fjalësh të trajtuara te ne si pasthirrma¹². Në këtë Gra-

⁶Vep. e cit., f. 217.

⁷Po aty, f. 219

⁸Po aty, f. 219.

⁹Shih veprën e cituar, f. 122.

¹⁰Shih vep. e cit., f. 345- 348.

¹¹Shih *Gramatikën e gjuhës shqipe II*, Tiranë, 1997, f. 407- 408.

¹²Shih *Gramatikën e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 1995, f. 427- 436.

matikë të gjuhës frënge është karakteristike se këto **fjalë- fraza** konsiderohen si pjesë më vete të ligjëratës. Kjo tregon se në klasifikimin e pjesëve të ligjëratës më shumë është favorizuar *kriteri sintaksor*, sesa *ai morfologjik ose semantik*. Ndërkaq, grupi i fjalëve të tipit: *certainement, certes, peut- entre, vraiment, sans doute, bien sur* etj., konsiderohen, me të drejtë, **si ndajfolje të frazës** (les adverbess de phrase), me arsyetimin se ato edhe si ndërtime të ndërmjetme, nuk i referohen një fjale, por tërë frazës (L' element incident)¹³, por duke mos e mohuar faktin se këto në disa raste mund të dalin edhe me vlerën e **përgjegjëseve të frazës**, si p. sh.: *Une panne de lumiere de bord, ça peut etre grave! -Bien sur, (Saint Exupery)*¹⁴ etj.

Sido që të jetë, është shumë më afër mendsh që fjalëzat: **po, jo**, kur përdoren në situatat e ndryshme të bashkëbisedimit, të trajtohen si përgjegjëse fjalish, sesa ndajfolje **pohimi, mohimi ose koment**, sepse ngërthejnë në vete ndonjë bërthamë kallëzuesore dhe shqiptohen me një intonacion të përmbarimit. Këto dy fakte na çojnë kah teza se fjalët e këtilla do të duhej t'i trajtonim kryesisht si të këtilla dhe jo si ndajfolje ose si pjesëza, siç konsiderohen tradicionalisht në gramatikat tona.

Nga këto të dhëna që u sollën këtu del se në klasifikimin e ndajfoljeve, jo vetëm në gjuhën tonë, por edhe në gjuhë të tjera, ka inkonsekueca, madje shpeshherë edhe pasaktësi etj., të cilat dalin, në radhë të parë, nga heterogjeniteti i tyre, por edhe nga vetë mënyra e qasjes së studimit të tyre, nga kriteret që merren parasysh etj. Por, jemi të mendimit se asnjëherë nuk do të kemi një klasifikim të plotë, të saktë, nëse nuk inkorporohet dhe merret parasysh, në radhë të parë, kriteri sintaksor, sipas të cilit çdo element gjuhësor duhet vështrohet si i paveçuar nga korpusi gjuhësor, gjithnjë në bashkëveprim të plotë me elemente të tjera që shprehin kumtim të caktuar nga realiteti objektiv. Dhe këtu qëndron rëndësia më e madhe e këtij kriteri dhe funksioni pragmatik i gjuhës, duke mos e mohuar asnjëherë anën sematike dhe morfologjike të tyre.

¹³Vep., e cit., f. 111, 316 dhe 346.

¹⁴Vep. e cit., f. 346.